



Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

## THIRRJE PUBLIKE nr. 08/2014 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2014

### I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Masa 1	Mbështetje teknike në bujqësi dhe zhvillim rural	Vlera maksimale e shpëzimeve të pranueshme (deri më)
Nënmasa 1.4	Ndihmë për marketing të prodhimeve bujqësore dhe prodhimet e përpunuara bujqësore	24.019.740,00 denarë
1.4.1	Harxhime për ambalazhim të prodhimeve të përpunuara bujqësore (verë) Mjetet u dedikohen për sektorin e verës për eksport të realizuar në vitin 2014 të verës në shishe me prejardhje nga Republika e Maqedonisë	
1.4.2	Harxhime për ambalazhim të prodhimeve të përpunuara bujqësore (përpunime të perimeve) Mjetet u dedikohen për përpunim të perimeve të eksportuara në ambalazh qelqi dhe me prejardhje nga Republika e Maqedonisë në vitin 2014	
1.4.3	Ndihmë financiare për njësi prodhim për prodhim të eksportuar bujqësor në ambalazh (oriz) Mjetet dedikohen për kilogram oriz të eksportuar në paketim (përveç se në thasë) dhe me prejardhje nga Republika e Maqedonisë në vitin 2014	
1.4.4	Harxhime për transport të prodhimit bujqësor – rrush për verë nga vendi i regjistruar për grumbullim të prodhimit bujqësor – rrush për verë deri në vendin kapaciteti përpunues për prodhimin e verës Mjetet u dedikohen për harxhimet e bëra për transport të rrushtit të grumbulluar për verë nga pika e regjistruar për grumbullim deri tek kapaciteti i regjistruar për përpunim për prodhim të verës	

### II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

Subjektet	Nënpikat
Subjekte juridike që kanë kapacitet të regjistruar për përpunim për prodhim të verës në Regjistrin e prodhuesve të verës në pajtim me Ligjin për verë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 50/2010, 53/2011, 06/2012, 23/2013, 106/2013 dhe 188/2013)	1.4.1
Subjekte juridike të cilat janë të regjistruara në Regjistrin e operatorëve me ushqim dhe objektet me prejardhje joshnozore në pajtim me Ligjin për siguri në ushqim ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 157/2010, 53/2011, 01/2012, 164/2013, 187/2013 dhe 43/2014)	1.4.2
Subjekte juridike të cilat janë të regjistruara për realizim të grumbullimit të orizit në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013 dhe 43/2014)	1.4.3
Subjekte juridike të cilat kanë të regjistruar kapacitet përpunues për prodhim të verës në Regjistrin e prodhuesve të verës në pajtim me Ligjin për verë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 50/2010, 53/2011, 06/2012, 23/2013, 106/2013 dhe 188/2013)	1.4.4

### III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Për nënpikën 1.4.1 mbështetja financiare paguhet në shumë deri më 20% nga vlera e përgjithshme e harxhimeve të bëra për ambalazhim të verës së eksportuar në shishe e cila duhet të përbëhet nga shishja e qelqtë, tapë, PCV kapsollë, etiketë të parme dhe pasme, por jo më shumë se 6 denarë për verë të eksportuar në shishe.

Për nënpikën 1.4.2 mbështetja financiare paguhet në shumë deri më 20% nga vlera përgjithshme e harxhimeve të bëra për ambalazhim e cila përbëhet nga kavanoz qelqi, kapak për kavanoz, etiketë të parme dhe të prapme, por jo më shumë se dy denarë për kilogram të eksportuar të perimeve të përpunuara, dhe/ose ndërsa për sasi të eksportuara në krahasim me vitin 2013 ndihma është jo më shumë se 4 denarë për kilogram të eksportuar të perimeve të përpunuara me prejardhje nga Republika e Maqedonisë në vitin 2014.

Mbështetja financiare për nënpikën 1.4.3 është prej maksimum 2 denarë për kilogram të orizit të eksportuar në paketim (përveç thasëve).

Mjetet për nënpikën 1.4.4 do të ndahen për harxhime të bëra për transport të rrushtit të grumbulluar për verë nga punkti i regjistruar për grumbullim deri tek kapaciteti i regjistruar për përpunim të verës edhe atë në shumë sipas largësisë së pikës së regjistruar për grumbullim deri tek kapaciteti i regjistruar për përpunim për prodhim të verës edhe atë:

- deri më 0,45 den/kg rrush për verë për largësi deri më 30 km
- deri më 0,75 den/kg rrush për verë për largësi prej 31km deri më 80 km
- deri më 1,25 den/kg rrush për verë për largësi prej 81km deri më 110 km
- deri më 1,50 den/kg rrush për verë për largësi mbi 111km.

### IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Mjetet financiare nuk paguhen nëse kërkuesi në ditën e dorëzimit të kërkesës ka obligime të pa paguara ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkuesit e mjeteve janë përcaktuar në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural, Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2014, Rregulloren për llojin e aktiviteteve, shumën maksimale për aktivitet, shfrytëzuesit, subjektet të cilat marrin pjesë në procedurë, kriteret më të përafërta dhe mënyrën për ndarjen e mbështetjes teknike në bujqësi dhe zhvillim rural.

Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjete të disponueshme në pajtim me Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2014, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkuesve të cilët kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Një shfrytëzues dorëzon kërkesë të veçantë për secilën masë në origjinal. Një shfrytëzues mund të dorëzojë më së shumti dy kërkesa për shfrytëzim të mbështetjes në masa të ndryshme nga ky program.

### V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formulari – Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhezimin e shfrytëzuesve mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk), dhe drejtpërdrejtë në Agjenci në adresën:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloko C)  
1000 Shkup

### VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2014 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 08/2014 dhe shënimin e shifrës së masës/nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për të gjitha nënpikat të nënmasës 1.4 është 15.01.2015. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) и dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejm të projekteve.



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL